



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË



Nr. ____ Prot

Korçë, më 29.08.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (paraparak)

Date 29.08.2024

Drejtuar: *Shoqërisë "KORSEL" sh.p.k* adresa: Korçë , Lagjja 17, Rruga Midhi Kostani, Prane Hipotekes, Objekti Nr. 23

Procedura e prokurimit: **Procedure e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF- 15863-08-09-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **"Mirëmbajtja e varrezave publike e të dëshmorëve"**

Afati: **12 muaj nga data e lidhjes te kontrates**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : **Nr 51, Date 19.08.2024**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqeria "NIKA" shpk, NIPT J76705047U me vlerën:

3.227.049,65 (tre milion e dyqind e njezet e shtate mije e dyzet e nente, presje gjashtedhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

2. Shoqeria "GRAMA" shpk, NIPT J77304712J me vlerën:

3.583.284 (tre milion e peseqind e tetedhjetë e tre mije e dyqind e tetedhjetë e kater) lekë pa tvsh.

3. Shoqeria "KORSEL" shpk, NIPT J64104124G, me vlerën:

3.818.531,58 (tre milion e teteqind e tetembedhjetë mije e peseqind e tridhjetë e nje, presje pesedhjetë e tete)lekë pa tvsh

4. Shoqëria “ ED KONSTRUKSION ” sh.p.k , NIPT K61625001L me vleren:

4.146.690,07 (kater milion e njeqind e dyzet e gjashte mije e gjashteqind e nentedhete, presje shtatë)lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria “ NIKA ” shpk, per arsye se:

Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 8,kriteret e vecanta të kualifikimit,pika 2.2.1 ku është përcaktuar shprehimisht se:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Konkretisht: Për plotësimin e këtij kriteri ofertuesi ka paraqitur kontratën me objekt “Mirëmbajtje objekte” e cila ka përfunduar në datën 22.11.2019.

Kjo kontratë nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit dhe gjithashtu nuk është kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës.

2. Shoqëria “ GRAMA ” shpk, per arsye se:

1. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 8,kriteret e vecanta të kualifikimit pika 1.b ku përcaktohet shprehimisht se: *“Ofertuesi duhet të paraqesë: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Konkretisht: Ofertuesi nuk ka dorëzuar sigurim oferte.

2. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 8,kriteret e vecanta të kualifikimit **pika 2.2.2 ku përcaktohet shprehimisht se “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me Licensë për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)”**

Konkretisht: Ofertuesi nuk ka dorëzuar licensën e kërkuar më sipër.

3. Shoqëria “ ED KONSTRUKSION ” shpk, per arsye se:

1.Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 8,kriteret e vecanta të kualifikimit,pika 2.2.1 ku është përcaktuar shprehimisht se:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastet kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastet kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Konkretisht : Për plotësimin e këtij kriteri ofertuesi ka paraqitur kontratat me objekt “Sherbim i pastrimit ne Bashkinë Ura Vajgurore” të lidhura në datë 20.10.2021 dhe datë 21.10.2022.

Këto kontrata janë lidhur ndërmjet Bashkimit të operatorëve “Ed Konstruksion sh.p.k dhe “Korsel” sh.p.k. Për këto kontrata nuk janë paraqitur Kontratat e Bashkimit të operatorëve ekonomikë sic është përcaktuar në kriterin e sipërcituar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “**KORSEL** ”sh.p.k adresa: **Korçë , Lagjja 17, Rruga Midhi Kostani, Prane Hipotekes, Objekti Nr. 23**, se oferta e paraqitur me vlerë totale 3.818.531,58 (tre milion e teteqind e tetembedhjete mijë e peseqind e tridhjetë e një, presje pesedhjetë e tete)lekë pa tvsh, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**